

**Deklaratë për Shtyp**

**ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR  
GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2008**

\_\_\_ Gusht 2008

Bilanci i përgjithshëm i pagesave, për gjashtëmujojin e parë të vitit 2008, rezultoi me një pakësim mjetesh valutore prej 17 milionë eurosh. Flukset hyrëse të kapitalit mundësuan në masën 84.6 për qind, financimin e deficitit korent.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Rritje intensive të shpenzimeve dhe të të ardhurave korente.
- Thellim i mëtejshëm i deficitit tregtar dhe i atij korent.
- Rritje të flukseve hyrëse të kapitalit në formën e investimeve të huaja direkte dhe të huamarrjes së sektorit shtetëror.
- Rënie e rezervave valutore të autoritetit monetar.

**I. LLOGARIA KORENTE**

Transaksionet korente, të zhvilluara gjatë gjysmës së parë të vitit 2008, vlerësohen në rreth 4.2 miliardë euro me një rritje vjetore prej 12.6 për qind. Shkëmbimet tregtare në mallra dhe shërbime kryesojnë vëllimin e transaksioneve korente të Shqipërisë me botën. Mëse 95 për qind e shpenzimeve korente gjatë kësaj periudhe, kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh, ndërkohë që, rreth 30 për qind e të ardhurave korente kanë hyrë në formën e transfertave. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve siguruan përkatësisht 25.6 për qind dhe 34.7 për qind të të ardhurave korente.

Deficiti korent, për këtë gjashtëmujo, u vlerësua rreth 591 milionë euro, me një rritje prej rreth 1.6 herë kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2007.

Deficiti i lartë tregtar, duke mbetur shkaktari kryesor në thellimin e deficitit korent për këtë periudhë, është shoqëruar edhe me deficitin e tregtisë së shërbimeve me rreth 83 milionë si dhe me ngushtim të suficitit të të ardhurave faktoriale neto dhe transfertave korente.

## **I.1. TREGTIA E JASHTME<sup>1</sup>**

Gjashtëmujori i parë i vitit 2008 karakterizohet nga një fluks i lartë shkëmbimesh tregtare. Vëllimi i përgjithshëm tregtar këtë gjashtëmujor arriti afërsisht vlerën e 2,038 milionë eurove, duke u vlerësuar 18 për qind më i lartë se niveli i të njëjtës periudhë të vitit paraardhës, me një përfaqësi rreth 48 për qind në totalin transaksioneve korente të vendit tonë.

Ritme të larta rritëse regjistrohen si për eksportet, ashtu edhe për importet, respektivisht 18.6 për qind dhe 17.1 për qind. Defititi tregtar gjatë këtij gjashtëmujori arriti në 1,2 miliardë euro ose 16.6 për qind më i lartë se periudha korresponduese e një viti më parë. Megjithatë, vërehet një rënie në ritmet e rritjes së deficitit tregtar krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2007 (5.7 pikë përqindjeje).

Në terma absolutë, të ardhurat nga eksportet në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2008 kanë arritur vlerën e 465.6 milionë eurove, ndërkohë që 1.65 miliardë euro janë shpenzuar për blerje mallrash. Baza e ulët e eksporteve munda të mbulojë gjatë këtij gjashtëmujori, rreth 28 për qind të shpenzimeve për importe, nivele këto që karakterizojnë tregtinë e jashtme të vendit gjatë viteve të fundit.

Megjithëse industria përpunuese përbën pjesën dërrmuese të eksporteve të vendit tonë duke përfaqësuar 62.7 për qind të tij, gjatë këtij gjashtëmujori ka pësuar një rënie prej 6.5 për qind në nivel përfaqësimit. Ndikimin më të ndjeshëm në këtë rënie e ka dhënë grupmali “këpucë e artikujt e tyre” duke u vlerësuar 11.2 për qind më i ulët se gjashtëmujori i parë i vitit 2007. Ndërkohë që, grupmali “tekstile dhe artikujt e tyre” ka humbur 4 pikë përfaqësimit krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke u vlerësuar 43.4 për qind ndaj totalit të eksporteve.

Shenja premtuese shfaq dhe eksporti i brendshëm i vendit tone, i cili ka pësuar një rritje të ndjeshme prej 44 për qind. Ky fenomen është tregues i rëndësishëm i përmirësimit jo vetëm të kapacitetit prodhues të biznesit vendas, por edhe i shfrytëzimit efektiv të përparësive, që vijnë nga marrëveshjet e tregtisë së lirë me rajonin dhe Bashkimin Evropian.

Peshën më të madhe të eksportit të brendshëm e zënë produktet minerale dhe metalet bazë. Produktet minerale (që përfaqësojnë 43 për qind të eksportit të brendshëm), janë rritur me rreth 50 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2007. Kjo rritje, ka ardhur si rezultat i shtimit të kapacitetit prodhues vendas në lëndë të para minerale si sulfuret, oksidet si dhe lëndët djegëse. Gjithashtu, metalet bazë gjatë këtij gjashtëmujori janë dyfishuar, duke rritur nivelin e përfaqësimit në totalin e eksportit të brendshëm, nga 24 për qind gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2007 në 35 për qind, në fund të këtij gjashtëmujori.

Importet e lëndës së parë, të përqendruara kryesisht në tekstile, metale dhe lëkurat e papërpunuara, përfaqësuan 13 për qind të totalit të importeve. Shpenzimet për importe mallrash tekstilë janë rritur me 14 për qind, ndërkohë që importet e metaleve dhe lëkurës kanë pësuar rënie prej 11 dhe 6 për qind, respektivisht.

---

<sup>1</sup> Vlerat e llogaritura në tregtinë e mallrave i referohen vlerës c.i.f. për importet dhe f.o.b për eksportet.

Kërkesa e lartë për importe është reflektuar edhe në rritjen e shpenzimeve për produkte minerale si dhe makineri e pajisje, të cilat zënë 18 dhe 15 për qind repektivisht ndaj totalit të importeve. Importet e produkteve minerale rezultojnë 27.5 për qind më të larta se viti paraardhës. Gjithashtu, shpenzimet për makineri e pajisje janë rritur me 26.6 për qind, tipar ky i rritjes dhe zhvillimit të investimeve në vend sidomos në sektorë të tillë si ndërtime, infrastrukturë si edhe pajisje elektroshtëpiake.

Ndërkohë, vlen të theksohet se rritja e importeve gjatë kësaj periudhe ka qenë produkt jo vetëm i rritjes së kërkesës vendase për mallra importi por edhe i inflacionit të lartë të importuar nga Eurozona, partneri kryesor në tregtinë tonë të jashtme.

Në klasifikimin e importeve në përputhje me llogaritë kombëtare, vërehet se vendi ynë është i orientuar drejt importit të mallrave të ndërmjetëm, të cilët përfaqësuan rreth 53 për qind të totalit të importit. Në terma relativë krahasuar me një vit më parë, shpenzimet për importin e tyre u rritën me 18.3 për qind. Kontributin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë importet e mallrave industrialë të përpunuar, me një rritje prej 35.7 milionë eurosh.

Mëse 33 për qind e shpenzimeve të vendit tonë shkojnë për mallra konsumi që kanë shënuar një rritje vjetore prej 17 për qind. Ndërkohë që, mallrat kapitalë rezultuan 18 për qind më të lartë se periudha korresponduese e vitit 2007.

Përmirësimi i situatës energjitike në vend ka sjellë që importet e energjisë elektrike, gjatë këtij gjashtëmujori, të reduktohen në vëllim me 2.1 për qind. Ndërkohë që, në vlerë kanë pësuar një rritje prej 15 për qind, rezultat ky i rritjes së çmimit të gazit dhe elektricitetit.

Karburantet dhe lubrifikantët kanë pësuar një rritje prej rreth 33 për qind në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit paraardhës, duke përfaqësuar kështu 15.5 për qind të totalit të shpenzimeve për import. Prirja e theksuar rritëse që karakterizon çmimin e naftës në tregjet ndërkombetare, ka ndikuar në rritjen e çmimit të lëndëve të para dhe në krijimin e presioneve inflacioniste, duke influencuar kështu negativisht në ekonominë vendase e atë botërore.

Përsa i përket shpërndarjes gjeografike, vendet e Bashkimit Evropian mbeten dominuese në peshën që zënë në tregtinë e jashtme të vendit tonë (rreth 54 për qind). Vendet fqinje, Itali dhe Greqi përbëjnë respektivisht 35 dhe 13 për qind ndaj vëllimit të pergjithshëm tregtar të importeve, duke ruajtur të njëjtin nivel përfaqësimi krahasuar me një vit më parë.

Ndërkohë, importet nga partnerët rajonalë kanë pësuar rënie prej rreth 11 për qind gjatë këtij gjashtëmujori, duke ulur përfaqësinë e këtyre vendeve në totalin e importeve në 13 për qind. Efektin më të ndjeshëm e ka dhënë reduktimi i importeve nga Serbia, si rrjedhojë e zëvendësimit të tyre me mallra me kosto më të ulët dhe cilësi më të lartë, që vijnë nga vendet e BE-së si dhe të Lindjes së Lartë (Kina).

Hyrja në fuqi e CEFTA-s në korrik të 2007-ës, ka ndikuar pozitivisht në burimin e të ardhurave nga eksportet tona drejt rajonit. Këto janë rritur me rreth 50 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke zënë 14.3 për qind ndaj totalit të eksporteve. Tregtia me Maqedoninë dhe shtetin e ri të Kosovës ka dhënë kontributin kryesor në këtë rritje. Eksportet drejt Kosovës janë rritur me 53 për qind ndërsa ato të Maqedonisë me 78 për qind, duke përfaqësuar respektivisht 41.7 dhe 17.3 për qind të eksporteve me vendet e rajonit.

## **1.2. ZHVILLIMET NË ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE**

Transaksionet tregtare në shërbime arritën në 1.3 miliardë euro me një rritje vjetore prej 10 për qind.

Llogaria e shërbimeve u mbyll me një deficit prej 82.6 milionë eurosh i rritur rreth 6 herë kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, pasojë e ritmeve rritëse më të shpejta në kahun e importeve sesa eksporteve, në tregun ndërkombëtar të shërbimeve.

Lëvizjet në llogarinë e shërbimeve ndikohen ndjeshëm nga zhvillimet në shërbimet e udhëtimit (turizëm), të cilat kontribuojnë në masë të konsiderueshme flukset hyrëse dhe dalëse të kësaj kategorie, përkatësisht me 75 dhe 69 për qind të tyre për këtë gjashtëmujor.

Sipas Bankës së Shqipërisë, shërbimet e udhëtimit kanë shënuar një deficit prej 23 milionë eurosh, kundrejt suficitit të regjistruar në gjashtëmujorin e një viti më parë (10 milionë euro). Ky deficit ka ardhur si pasojë e rritjes më të shpejtë të importit të këtyre shërbimeve (28 për qind), kundrejt asaj në eksport (19 për qind).

Eksporti i këtyre shërbimeve, gjatë këtij gjashtëmujori ka sjellë rreth 471 milionë euro të ardhura, duke shënuar një rritje vjetore prej 19 për qind. Kjo erdhi si pasojë e rritjes së fluksit të jorezidentëve (45 për qind) që kanë vizituar vendin, 49 për qind e të cilëve cilësohen si emigrantë.

Importi në këtë sektor (udhëtime) vlerësohet 494 milionë euro, me një rritje vjetore prej rreth 28 për qind. Kjo ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të udhëtarëve me 36 për qind. Një tjetër faktor, që vazhdon të ndikojë në rritjen e importit të shërbimeve të udhëtimit është shpenzimi ditor i udhëtarëve, rrjedhim i nivelit të lartë të çmimeve që karakterizon vendet e Eurozonës, destinacionet kryesore të udhëtarëve rezidentë.

Shqipëria vazhdon të jetë importuese neto e shërbimeve të transportit dhe të sigurimit të mallrave, fenomen ky që lidhet natyrshëm me rritjen e importeve të mallrave dhe që ndikon drejtpërdrejt në deficitin e tregtisë së shërbimeve. Këtë gjashtëmujor deficiti i këtyre shërbimeve vlerësohet me një rritje vjetore prej 2.5 herë.

Ndërkohë, shërbimet e tjera shfaqin mundësi konkurrense në tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve kryesisht në shërbimet financiare, komunikacionit, dhe të konstruksionit, duke regjistruar suficit prej 21.4 milionë eurosh.

Ekonomia shqiptare vazhdon të përfitojë të ardhura në valutë prej punës së punonjësve sezonalë dhe investimeve të rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente dhe njëkohësisht, të paguajë interesat për borxhin e jashtëm. Rezultati neto i transaksioneve në të ardhura mbetet pozitiv edhe gjatë këtij gjashtëmujori, dhe vlerësohet në rreth 129 milionë euro me një rritje vjetore prej 33 për qind. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga investimet në formën e investimeve të portofolit dhe prej investimit të rezervës tonë valutore në institucione jorezidente. Njekohësisht, të ardhurat dalëse në formën e interesave të borxhit të jashtëm vlerësohen rreth 10.6 milionë euro, me një rënie prej 5 për qind kundrejt të njëjtës periudhë, një vit më parë.

Të ardhurat nga puna, në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar, vlerësohen në rënie me rreth 63.4 për qind, duke regjistruar shifrën e 21 milionë eurove.

Bilanci i transfertave korente, në fund të gjashtëmujorit të parë, u vlerësua në rreth 470 milionë euro. Peshën kryesore (rreth 79 për qind) të të ardhurave në këtë kategori, vazhdojnë ta zënë prurjet e emigrantëve shqiptarë me banim jashtë. Gjatë kësaj periudhe këto transferta kanë arritur nivelin 435 milionë euro dhe kanë financuar me rreth 39.2 për qind deficitin tregtar. Krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë këto transferta vlerësohen 7.3 për qind më të ulëta, pasi vihet re një zhvendosje e këtyre flukseve valutore, nga ato për përdorim korent në formën e investimeve.

## **II. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE**

Lëvizjet e kapitalit, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2008, regjistruan një fluks neto prej rreth 500 milionë eurosh dhe mundësuan, në masën 85 për qind financimin e deficitit korent. Pas kësaj shifre pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale hyrëse prej 31 milionë eurosh si dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 469 milionë eurosh.

Pozicioni i llogarisë financiare këtë periudhë përkufizohet në rritje të ndjeshme të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën (me rreth 435 milionë euro). Ndërkohë që, pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës kanë rënë me rreth 34.4 milionë euro.

Rritja e detyrimeve financiare ndaj botës, këtë gjashtëmujor, ka ardhur kryesisht prej flukseve hyrëse të kapitalit në formën e investimeve direkte dhe huamarrjes me jashtë si dhe të detyrimeve afatshkurtra në sistemin tonë bankar ndaj institucioneve të huaja financiare.

Investimet e huaja direkte vlerësohen në nivelin 226.7 milionë euro, me një rritje vjetore prej 1.5 herë. Këto flukse kapitali janë shndërruar në një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare të vendit.

Faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare kanë qenë lëvrimet e kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, të cilat e kanë shtuar detyrimet nga huamarrja me 145 milionë euro. Këto detyrime vlerësohen të jenë 2.5 herë më të larta kundrejt një viti më parë, si rrjedhojë e rritjes së huamarrjes nga jashtë nga sektori shtetëror.

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe interesit vlerësohen në rreth 41 milionë euro, të barazvlefshme me 8.8 për qind të eksportit të mallrave, tregues ky i aftësisë paguese të vendit brenda niveleve të pranuar.

Mjetet financiare të ekonomisë shqiptare vlerësohen me një rënie prej 34.4 milionë euro. Kjo rënie ka ardhur kryesisht nga investimi direkt me 29 milionë euro. Mjetet në formën e investimeve të portofolit (me një rënie prej 1.6 milionë eurosh) dhe të mjeteve valutore në formë huaje (me një rënie prej 9.4 milionë eurosh), janë zhvendosur në investime të rezervave të sistemit bankar në tregun ndërkombëtar, në formën e depozitave dhe mjeteve afatshkurtra. Këto të fundit janë rritur me 6.6 milionë euro.

Mjetet e rezervës të Autoritetit Monetar kanë rënë me 17.1 milionë euro. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2008, këto rezerva regjistruan nivelin e 1.42 miliardë eurove, të mjaftueshme për të mbuluar rreth 3.7 muaj importe mallrash dhe shërbimesh

**Bilanci i pagesave (në milionë euro).**

	6M-1 2007	6M-1 2008
Llogaria korente	-363.4	-590.8
		0.0
Eksporti i mallrave	392.1	465.6
Importi i mallrave	-1335.5	-1572.6
Bilanci tregtar	-943.4	-1107.0
Shërbimet: kredi	602.5	630.1
Shërbimet: debi	-616.8	-712.7
Të ardhurat: kredi	118.6	172.1
Të ardhurat: debi	-21.3	-42.8
Transferta private pa shpërblim	468.7	459.3
Transferta shtetërore pa shpërblim	28.2	10.1
Llogaria kapitale	43.5	30.6
Llogaria financiare	298.7	469.3
Investime direkte	147.4	256.5
Investime portofoli	18.5	1.6
Kapitale të tjera*	130.1	213.8
Gabime dhe harresa neto	58.8	73.8
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>37.6</b>	<b>-17.1</b>
Rezervat dhe zëra të lidhur me to		
Mjetet e rezervës	-37.6	17.1
Përdorim huash e kredish nga FMN	2.8	-2.7
Për t'u mbajtur në vëmendje		
Ndryshimi total në rezerva	<b>26.7</b>	<b>-55.6</b>
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	<b>-10.8</b>	<b>-38.5</b>

\* Nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.

Burimi: Banka e Shqipërisë.